



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Data: 28.6.2024

Nr: 13

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS NR. 02, DATË 4.6.2024 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË
ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 28.6.2024, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

OBJEKT:

Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ referuar vendimit nr. 48, datë 16.05.2024, "Për miratimin e raportit mbi gjetjet kyçe të procesit të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit, materialit zgjedhor dhe pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik (PEVN) të përdorura në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023 dhe për zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24.09.2023", të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

BAZË LIGJORE:

Nenet 19 pika 1 shkronja "c" dhe 21 pika 1 shkronja "dh" të Kodit Zgjedhor.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Rrethanat e çështjes:

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka zhvilluar procesin e këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore, nga data 06.11.2023 deri më 26.11.2023, me qëllimin për të verifikuar rregullsinë dhe saktësinë e veprimtarisë së administratës zgjedhore përgjatë administrimit të procesit dhe vlerësimit e numërimit të votave për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023. Këqyrjes iu nënshtruan 10% të qendrave të votimit, gjithësej 526 QV. Të dhënat e pasqyruara në procesverbalet përkatëse të këqyrjes u përpunuan dhe u analizuan. Në kuadër të procesit të analizës së gjetjeve, u konstatuan shkelje administrative dhe, mbi këtë bazë nisi procedimi administrativ për personat përgjegjës.
2. Nga datat 07.01.2024 deri me 31.1.2024 u zhvillua procesi i hetimit administrativ, duke identifikuar dhe më pas duke kërkuar sqarime anëtarëve të GNV-ve. Secilit prej personave, pjesë e grupeve të numërimit, iu komunikuan gjetjet nga procesi i këqyrjes dhe u kërkuan shpjegime/argumente nga ana e tyre lidhur me mospërputhjet në vlerësimin e votave për 11 QV gjithësej.
3. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të hetimit administrativ vendosi t'i kërkojë KAS-it vendosjen e sanksioneve administrative ndaj anëtarëve të 8 grupeve të numërimit të votave, gjithësej 28 persona.
4. Kërkesa e Komisionerit nr. 1490 Prot., datë 04.06.2024 kërkon vendosjen e sanksionit administrativ, sipas pikës 1 të nenit 171 të Kodit Zgjedhor, për:
 - Niko Preka, Ndoc Ndoci, Armando Lekaj dhe Lorenc Pjetraj, anëtarë të GNV-së për QV-0172/00;
 - Andi Daci, Arlind Babasi, Ergys Kaziu, Gazmend Kaziu, anëtarë të GNV-së për QV-1317/00;
 - Erti Bejdo, Dorian Allkja, Andon Shytermeja, Xhonatan Haxhia, anëtarë të GNV-së për QV-1420/05.
 - Klaus Shaqiri, Adriatik Nelaj, Klajdi Meçi, anëtarë të GNV-së për QV-1869/01;
 - Gerald Çeça, Marius Myftaraj, Ardit Billa, anëtarë të GNV-së për QV-2069/00;
 - Ardit Çanaku, Enea Karina, Xhulio Maçi, anëtarë të GNV-së për QV-2272/01;
 - Terion Mersuli, Gazmend Mulla, Klea Kordalli, Artan Mersuli, anëtarë të GNV-së për QV-4016/00;
 - Sebastian Guçi, Klevis Kaso, Fatjon Denaj, anëtarë të GNV-së për QV-4455/01;
5. Në raportin “mbi gjetjet e këqyrjes së mëpasshme të fletëve të votimit dhe e të materialit zgjedhor të përdorura nga komisionet zgjedhore në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023 dhe për zgjedhjet për kryetar të bashkisë Kukës të datës 24.09.2023”, ku është mbështetur kërkesa e Komisionerit, përcaktohet metodologjia e identifikimit të personave përgjegjës dhe e shkeljes që u atribuohet. Sipas kësaj metodologjie, “pasaktësitë deri në 20 vota do të konsiderohen gabime njerëzore, duke ju referuar për analogji standardeve teknike, kushteve

të punës, volumit të fletëve të votimit, natyrës së procesit dhe afateve kohore që dikton Kodi Zgjedhor për tabulimin e rezultateve”.

6. Për këtë arsye, Komisioneri ka kërkuar vendosjen e sanksionit administrativ vetëm për anëtarët e GNV-ve, të cilët kanë certifikuar një rezultat numërimi dhe vlerësimi të votave, i cili ndryshon nga rezultati i riverifikimit të kryer nga KQZ-ja, me mbi 20 vota.
7. Në përputhje me rregulloren “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, u hodh shorti për caktimin e relatorit dhe u caktua anëtari z. Ilirjan Rusmali relator i çështjes.
8. Në datën 11.06.2024 KAS-i zhvilloi seancën e shqyrtimit të kërkesës së Komisionerit në prani të përfaqësuesve të administratës së KQZ-së, të ngarkuar me përfaqësimin e kërkesës dhe me pjesëmarrjen e z. Armando Lekaj, z. Terion Mersuli, z. Gazmend Mulla, z. Artan Mersuli, z. Adriatik Nelaj, z. Ardit Çanaku dhe z. Andon Shytermeja. Personat e tjerë, të thirrur rregullisht, nuk u paraqitën, pa dhënë njoftim. Z. Klevis Kaso njoftoi pamundësinë për të marrë pjesë në seancë dhe znj. Klea Kordalli ndodhej jashtë shtetit. Në datën 28.06.2024 u zhvillua senaca për shpalljen e vendimit të KAS-it, në të cilën mori pjesë anëtari i GNV për QV-nr.2069/00 z. Gerald Çeça.
9. Pjesëmarrësit në shqyrtimin e kërkesës parashtruan në tërësi si shkak justifikues për parregullsitë në numërimin ose vlerësimin e votave shpërqëndrimin nga lodhja dhe puna e tejzgjatur me numërimin, në disa raste të më shumë se dhjetë kutive pa ndërprerje dhe pa u zëvendësuar nga grup tjetër numërimi. Përfaqësuesit e KQZ-së këtë justifikim e quajtën jo bindës.
10. KAS-i, pasi dëgjoi shpjegimet e palëve dhe përgjigjet e pyetjeve, mori në shqyrtim:
 - raportin e KQZ-së “mbi gjetjet e këqyrjes së mëpasshme të fletëve të votimit dhe e të materialit zgjedhor të përdorura nga komisionet zgjedhore në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023 dhe për zgjedhjet për kryetar të bashkisë kukës të datës 24.09.2023”;
 - tabelat e rezultateve për QV-0172/00, QV-1317/00, QV-1420/05, QV-1869/01, QV-2069/00, QV-2272/01, QV-4016/00 dhe QV-4455/01, të përpiluara nga personat e proceduar, si dhe tabelat e rezultateve për të njejtat QV të përpiluara nga KQZ-ja në procesin e verifikimit;
 - shkresat e KQZ-së nr. 120/53 Prot. dhe 120/62 Prot., datë 16.01.2024 drejtuar përkatësisht z. Niko Preka dhe z. Armando Lekaj, së bashku me përgjigjen e z. Niko Preka, protokolluar me nr. 187 prot., datë 22.01.2024, përgjigjen e z. Armando Lekaj, protokolluar me nr. 155 prot., datë 19.01.2024, përgjigjet e z. Ndoc Ndoci dhe të z. Lorenc Pjetraj, pa numër protokolli;
 - përgjigjen e z. Arlind Babasi, protokolluar me nr. 177 prot., datë 22.01.2024, përgjigjen e z. Ergys Kaziu, protokolluar me nr. 266 prot., datë 30.01.2024, përgjigjen e z. Andi Daci, protokolluar me nr. 266/1 prot., datë 30.01.2024;
 - përgjigjen e z. Andon Shytermeja, protokolluar me nr. 266/9 prot., datë 30.01.2024, përgjigjen e z. Erti Bejdo, protokolluar me nr. 266/20 prot., datë 30.01.2024, përgjigjen e z. Dorian Allka, protokolluar me nr. 266/5, datë 30.01.2024;
 - përgjigjen e përbashkët të disa anëtarëve të GNV-ve, përfshirë. z. Klaus Shaqiri, z. Adriatik Nelaj, z. Klajdi Meçi, protokolluar me nr. 156 prot., datë 19.01.2024;
 - përgjigjen e z. Erion Meta, protokolluar me nr. 266/3 prot., datë 30.01.2024;

- përgjigjen e z. Ardit Çanaku dhe përgjigjen e z. Enea Karina, komunikuar KQZ-së në format elektronik dhe përgjigjen e z. Xhuljo Maçi, protokolluar me nr. 186 prot., datë 22.01.2024;
- përgjigjen e z. Artan Mersuli, protokolluar me nr. 266/11 prot., datë 30.01.2024, përgjigjen e zj. Klea Kordalli, protokolluar me nr. 199 prot., datë 23.01.2024, përgjigjen e z. Terion Mersuli, protokolluar me nr. 266/22 prot., datë 30.01.2024;
- përgjigjen e z. Klevis Kaso, komunikuar KQZ-së në format elektronik.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstatoi:

1. Në QV-0172/00, GNV-ja për të cilën kërkohet vendosja e sanksionit administrativ ka numëruar votat për këshillin bashkiak. Rezulton se (18) vota të pavlefshme janë konsideruar të vlefshme nga GNV-ja, por ky vlerësim i gabuar ka shkuar në favor të disa subjekteve zgjedhore, një pjesë konkurrues me njeri tjetrin, gjë që duket se neutralizon efektin e këtij gabimi në rezultatin e QV-së. Vlerësimi i gabuar i votave të pavlefshme mund të trajtohet si gabim i justifikueshëm. Shqetësuese mbetet heqja e (15) votave nga subjekti “Aleanca Liberale e Djathtë” dhe shtimi i (17) votave në favor të subjektit “Partia Socialdemokrate”. Ky përkim forcon dyshimin se në këtë rast mund të jetë bërë zhvendosje e qëllimshme votash. Subjekti përfitues rezulton forcë e parë në këtë QV, si para ashtu dhe pas verifikimit.
2. Në QV-1317/00, GNV-ja për të cilën kërkohet vendosja e sanksionit administrativ ka numëruar votat për këshillin bashkiak. Nga verifikimi ka rezultuar se subjektit “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë” i janë shtuar (47) vota, nga të cilat (38) i janë hequr subjektit “Partia Socialiste e Shqipërisë”, (7) i janë hequr subjektit “Partia Unitetit Kombëtar” dhe (2) vota i janë hequr subjektit “Partia Balli Kombëtar”. Kjo lëvizje votash nuk mund të ketë qenë rastësore. Rastësor mund të ketë qenë kalimi i (1) vote nga subjekti “Aleanca Liberale e Djathtë”, tek subjekti “Bashkë Fitojmë”.
3. Në QV-1420/05, GNV-ja për të cilën kërkohet vendosja e sanksionit administrativ ka numëruar votat për këshillin bashkiak. Tabelat e rezultateve për këshillin, para dhe pas verifikimit, paraqesin ndryshime masive. Para së gjithash, numri i fletëve të gjetura në kuti gjatë verifikimit është (9) më shumë se numri i pasqyruar nga numërimi fillestar dhe nga numri i raportuar i votuesve. Ky është indikacion që hedh dyshime të forta mbi integritetin e administrimit të procesit për këtë kuti votimi, por për KAS-in është e pamundur të saktësojë përgjegjësitë.
4. Këto (9) fletë votimi më shumë që gjenden në kuti dhe që nuk mund të provohet se janë futur në kuti në momentin e numërimit të votave nga GNV-ja, gjithësesi nuk mbulojnë dot diferencën e madhe që rezulton nga verifikimi i vlerësimit të votave për subjektet zgjedhore. GNV-ja i ka dhënë padrejtësisht subjektit zgjedhor “Partia Demokratike” (35) vota më shumë. Edhe sikur (9) fletët e votimit të jenë futur nga jashtë si vota në favor të këtij subjekti, përsëri GNV-ja ka modifikuar rezultatin në favor të këtij subjekti, me së paku (26) vota, i ka hequr subjektit ‘Bashkë Fitojmë’ së paku (16) vota, subjektit “Partia Lëvizja e Legalitetit” së paku (8) vota, subjektit “Aleanca Liberale e Djathtë” së paku (6) vota, subjektit “Partia Demokracia Sociale” së paku (3) vota dhe subjekteve “Partia Socialiste e Shqipërisë” dhe “Aleanca Progresiste LZHK” nga (1)

votë, duke i shtuar, nga ana tjetër, subjektit “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet” (5) vota, subjektit “Partia Socialdemokrate” (1) votë dhe “Partia Agrare Ambientaliste” (1) votë. Ndryshimet e sipërcituara në rezultat nuk i përgjigjen asnjë modeli të pranueshëm “gabimi njerëzor”.

5. Në QV-1869/01, GNV-ja, për të cilën kërkohet vendosja e sanksionit administrativ, ka numëruar votat për kryetarin e bashkisë. Verifikimi ka treguar lëvizje votash në votimin për kryetar bashkie. GNV-ja votat e pavlefshme (13), pjesën dërrmuese të votave të kandidatit Roland Bejko (23) dhe votat e kandidatit Marko Dajti (2) i ka shpërndarë midis kandidatëve Erion Veliaj (25) dhe Belind Këlliçi (14). Kjo lëvizje nuk shpjegohet dot me gabim njerëzor.
6. Në QV-2069/00, GNV-ja për të cilën kërkohet vendosja e sanksionit administrativ ka numëruar votat për këshillin bashkiak. Nga verifikimi rezulton se GNV-ja një pjesë të votave të pavlefshme (19), një pjesë të votave të subjektit “Partia Demokratike” (10) dhe një pjesë të votave të subjektit “Partia Lëvizja e Legalitetit” (3) ia ka kaluar subjektit “Partia Republikane” (32). Kjo lëvizje nuk shpjegohet dot me gabim njerëzor. Shpjegimi i dhënë nga anëtari z. Gerald Çeça lidhur me diskordancën midis votave të pavlefshme (kutia ka pasur fletë të lagura dhe numërimi i votave është bërë me urdhër të KZAZ-së) nuk është llogjik. Sipas këtij shpjegimi fletët e pavlefshme duhet të ishin në numër të lartë, kur në fakt rezulton se GNV-ja ka nxjerrë vetëm (7) fletë votimi të pavlefshme.
7. Në QV-2272/01, GNV-ja për të cilën kërkohet vendosja e sanksionit administrativ ka numëruar votat për këshillin bashkiak. Nga verifikimi rezulton se një pjesë e votave të subjektit “Partia Socialiste e Shqipërisë” (19, 20 ose 21) dhe eventualisht një votë e subjektit “Partia Socialdemokrate” ose (1) ose (2) vota të pavlefshme i janë shtuar subjektit “Partia Republikane Shqiptare” (22) dhe subjektit “Aleanca liberale e Djathtë” (2). Kjo lëvizje nuk shpjegohet dot me gabim njerëzor. Justifikimi mund të rrijë vetëm për diferencën (2 vota) në vlerësimin e votave të pavlefshme.
8. Në QV-4016/00, GNV-ja për të cilën kërkohet vendosja e sanksionit administrativ ka numëruar votat për këshillin bashkiak. Nga verifikimi rezulton se një pjesë e votave të subjektit “Bashkë Fitojmë” (20) dhe një pjesë e votave të pavlefshme (6) u janë shtuar subjekteve “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet” (20) dhe “Partia Socialdemokrate” (6). Kjo lëvizje nuk shpjegohet dot me gabim njerëzor. Justifikim mund të kishte vetëm për (6) votat e pavlefshme, nëse shpërndarja e tyre nuk do shkonte në favor të vetëm dy subjekteve.
9. Në QV-4455/01, dy nga tre anëtarët e GNV-së kanë numëruar si votat për kryetarin e bashkisë, ashtu dhe votat për këshillin bashkiak. Nga verifikimi rezulton se votat për kryetarin e bashkisë përputhen plotësisht. Në votat për këshillin rezultojnë lëvizje në favor të subjekteve “Bashkë Fitojmë” (11 vota) dhe “Partia Demokracia Sociale” (16 vota). Për të shtuar votat tek këta subjekte janë përdorur votat e pavlefshme (9) dhe një pjesë e votave të subjekteve “Partia Socialiste e Shqipërisë” (6), “Partia Demokratike” (5), “Partia Republikane Shqiptare” (3), “Partia Socialdemokrate” (2), “Partia Agrare Ambientaliste” (1) dhe “Fryma e Re Demokratike” (1).
10. KAS-i këqyri të gjitha tabelat e rezultateve për QV-të e marra në shqyrtim. Të gjitha tabelat rezultonin të plotësuara pa gabime drejtshkrimore, në përgjithësi me kaligrafi të rregullt dhe pa shkarravitje. Nëse plotësimi i tyre do të ishte bërë në kushtet e drobitjes, drobitja me gjasë do kishte sjellë vështirësi në plotësimin e tabelave.

11. Po kështu, KAS-i konstatoi rregullsi në përkimin e shifrave. Shifrat që hidhen në tabela kanë lidhje me njera tjetrën, si shumatore ose si diferenca. Drobitja mund të shkaktojë prishjen e këtij korrelacioni, sepse lodhja vështirëson kryerjen e veprimeve matematikore. Kjo gjë nuk u vu re në asnjërin nga tabelat e plotësuar.
12. Në seancën e pyetjeve me anëtarët e GNV-ve të pranishëm nuk u ngrit asnjëherë pretendimi, se diferencat mund të kishin ardhur nga shpërqendrimi për shkak të ngjarjeve apo incidenteve në mjediset e KZAZ-së. Pyetjes së KAS-it për këtë situatë, të gjithë anëtarët e GNV-së që ishin të pranishëm në seancë iu përgjigjën negativisht. Përgjatë procedurave të tyre të numërimit nuk kishte pasur ngjarje apo incidente që mund të tërhiqnin vëmendjen e tyre dhe t'i shpërqendronin në numërim.
13. Në përgjithësi, lëvizjet e votave në të gjitha QV-të e marra në shqyrtim, indikojnë lëvizje sipas një modeli: pavarësisht se nga merren votat, ato shkojnë masivisht në favor të një ose dy subjekteve të përcaktuara. Kjo lloj lëvizjeje nuk ka gjasa të jetë ngatërresë, sidomos kur bëhet fjalë për një numër të lartë votash.
14. Mbështetur në këtë arsyetim dhe në parregullsitë e gjetura për çdo tabelë, KAS-i krijon bindjen se justifikimi për lodhje të tejskajshme gjatë kryerjes së procedurave për këto kuti nuk qëndron. Nëse anëtarët e këtyre GNV-ve kanë numëruar më shumë kuti, se sa lejon kuadri ligjor, pa u zëvendësuar ose pa kërkuar që të zëvendësohen, atëherë ky fakt duhet të merret nga KAS-i si provë e tërthortë e faktit që numëruesit nuk kanë qenë në kushtet e lodhjes ekstreme, në momentin që kanë kryer këto procedura, përndryshe ata do të kishin kërkuar zëvendësimin, sikurse u njihet dhe garantohet nga Kodi Zgjedhor.
15. KAS-i vendosi të aplikojë masë të diferencuar sanksioni, mbështetur në kriterin sasior të parregullsisë së konstatuar. Në QV-1317/00, QV-1420/05, QV-1869/01 dhe QV-2069/00 zhvendosja e votave në favor të subjekteve të caktuara shkon nga 32 vota deri në 47 vota. Në QV-0172/00, QV-2272/01, QV-0416/00 dhe QV-4455/01 kjo zhvendosje shkon nga 17 vota deri në 27 vota.
16. KAS-i u interesua të dinte, nëse kishte pasur gjatë procesit kontestime të numërimit dhe të vlerësimit të votave për këto QV. Përgjigja mohuese si nga anëtarët e GNV-ve të pranishëm, ashtu dhe nga administrata e KQZ-së tregon se, në rastet e marra në shqyrtim, nuk ka funksionuar vëzhgimi i procesit, i cili është komponent vendimtar për mbarëvajtjen e tij. Subjektet zgjedhore kanë të drejtën ligjore të vëzhgojnë procesin, si dhe të gjitha garancitë për transparencën e tij, pikërisht për të siguruar korrektesën dhe rregullsinë e numërimit, vlerësimit dhe të tabulimit të votave. Këtë mangësi, që nuk varet nga anëtarët e GNV-së, KAS-i është i detyruar t'a marrë në konsideratë në përcaktimin e masës së sanksionit administrativ, si rrethanë që shkon në lehtësim të pozitës së personave, subjekt i këtij procedimi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj anëtarëve të GNV-ve të kutive të votimit për qendrat e votimit nr. 0172/00, nr. 1317/00, nr. 1420/05, nr. 1869/01, nr. 2069/00, nr. 2272/01, nr. 4016/00, dhe nr. 4455/01 në zgjedhjet e datës 14 maj 2023, sipas pikës 1 të nenit 171 të Kodit Zgjedhor.
2. Vendosjen e sanksionit administrativ gjorbë, në masën 20 mijë lekë për secilin anëtar të GNV-ve për QV-1317/00, Andi Daci, Arlind Babasi, Ergys Kaziu dhe Gazmend Kaziu, për QV-1420/05, Erti Bejdo, Dorian Allkja, Andon Shytermeja, Xhonatan Haxhia, për QV-1869/01, Klaus Shaqiri, Adriatik Nelaj, Klajdi Meçi dhe për QV-2069/00, Gerald Çeça, Marius Myftaraj, Ardit Billa.
3. Vendosjen e sanksionit administrativ gjorbë, në masën 15 mijë lekë për secilin anëtar të GNV-ve për QV-0172/00, Niko Preka, Ndoc Ndoci, Armando Lekaj dhe Lorenc Pjetraj, për QV-2272/01, Ardit Çanaku, Enea Karina, Xhulio Maçi, për QV-4016/00, Terion Mersuli, Gazmend Mulla, Klea Kordalli, Artan Mersuli, për QV-4455/01 Sebastian Guçi, Klevis Kaso, Fatjon Denaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative“, të ndryshuar” mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga njoftimi i tij.

Njoftuar palëve të pranishme me shpalljen.

U shpall sot më datë 28.6.2024

Ilirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar